



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.12, datë 27.07.2022

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT NË INFRASTRUKTURË PËR OBJEKTIN:
“LINJA NDËRMJET SHESHEVE TË EKSPLORIMIT SHPIRAG 4 DHE SHPIRAG 5”.
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË BERAT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Shell Upstream Albania B.V” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit në Infrastrukturë për objektin: “Linja ndërmjet shesheve të eksplorimit Shpirag 4 dhe Shpirag 5”, me vendndodhje në Bashkinë Berat, me subjekt zhvillues shoqërinë “Shell Upstream Albania B.V” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Berat.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

